

01-564

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština – Municipality of Prishtina	
---	--	---

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-55560/21 dt. 25.03.2021, të pronarëve Ismajl Qyqalla, Ali Qyqalla, Mehdi Qyqalla dhe Sami Qyqalla nga Prishtina dhe investitorit “Nura Group” sh.p.k. me adresë në lagjen Mati 1, rr. “Ndue Përlleshi, nr. A-10, H-1, Komuna Prishtinë, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën shumë banesore me afarizëm, ndërtuar në Lagjen “Mati 1”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 02.05.2025, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET pronarëve Ismajl Qyqalla, Ali Qyqalla, Mehdi Qyqalla dhe Sami Qyqalla nga Prishtina dhe investitorit “Nura Group” sh.p.k. me adresë në lagjen Mati 1, rr. “Ndue Përlleshi, nr A-10, H-1, Komuna Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit ARBK 810806804, me përfaqësues Faruk Nura, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-55560/21 dt. 25.03.2021, përdorimi i ndërtesës shumë banesore me afarizëm, me etazhitet B+P+8ET, e ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-7781 dt. 27.06.2011, në kuadër të bllokut urban “A-10”, të tërësisë “A”, të Planit Rregullues “Mati 1” në Prishtinë konkretisht në parcelën kadastrale nr. 1875-0, ZK Matiçan.

II. Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugët “Ali Aliu Kelmendi” dhe “Abdurrahim Buza” ku janë dalje hyrje e kësaj ndërtese me numër: 4, 6, 8, 10, 12, 14, 35, 37, 39, 41, 43, 45, 47, 49 dhe 51 në Prishtinë, dhe e njëjta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës dhe njësive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

A r s y e t i m

Pronarët Ismajl Qyqalla, Ali Qyqalla, Mehdi Qyqalla dhe Sami Qyqalla nga Prishtina dhe investitorit “Nura Group” sh.p.k. me certifikatë të regjistrimit ARBK 810806804, me përfaqësues Faruk Nura, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-55560/21 dt. 25.03.2021, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën shumë banesore me afarizëm, me etazhitet B+P+8ET, të ndërtuar në kuadër të bllokut urban “A-10”, të tërësisë “A”, të Planit Rregullues “Mati 1” në Prishtinë konkretisht në parcelën kadastrale nr. 1875-0, ZK Matiçan., ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore

05 Nr. 351-7781 dt. 27.06.2011, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit, dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkuessit kanë prezantuar dokumentacionin; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të ndërtesës, nga udhëheqësi i punishtes Sami Idrizi; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikëqyrësi Naim Matoshi; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikëqyrësi Sami Idrizi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikëqyrësi Muhedin Morina; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektrike, nga mbikëqyrësi Bekim Beqiri; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikëqyrësi Shukri Krasniqi.

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Komisionit profesional të pranimit teknik, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumë banesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim nr. 04/L-110, janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezantuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shumë banesore me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesën shumë banesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI

Ky vendim u printua në 6 (gjashtë) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuessve/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

DREJTORIA E URBANIZMIT DHE MJEDISIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-55560/21 DT. 02.05.2025

Zyrtari,
Berim Osmanaj



Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi